PLANI 5-VJEÇAR PËR
STREHIMIN SOCIAL NË BASHKINE POLIÇAN
2023-2027



(viii) "Programe sociale strehimi'' janë programe që shërbejnë për strehimin e familjeve dhe të individëve që nuk kanë banesë dhe jetojnë në mjedise që nuk klasifikohen si vende për banim apo në një banesë të përkohshme, ne kuptimin e ligjit për strehimin, që nuk kanë mundësi ekonomike dhe financiare për të siguruar një banesë, si dhe ato familje/individë, banesa e të cilëve është nën normën ligjore të strehimit dhe që nuik kanë të ardhura që të sigurojnë pagesën për një qira minimale në tregun e lirë.
(ix) "Strukturë përgjegjëse në njësinë e vetëqeverisjes vendore" është një drejtori, sektor ose njësi e qëndrueshme dhe e trajnuar, që mbulon çështjet e strehimit.
(x) ''Qira reale'' është vlera aktuale e çmimit të qirasë së një banese të caktuar në tregun e lirë.
(xi) ''Subvencion i qirasë'' është shuma e të hollave që jepet nga institucionet shtetërore për llogari të përfituesit, me qëllim mbulimin e pjesës së qirasë, e cila nuk përballohet me të ardhurat e përfituesit.
(xii) "Familje njëprindërore, që kanë në ngarkim fëmijë" është nëna apo babai i vetëm që kanë në ngarkim fëmijë.
(xiii) "Normë e strehimit" është koeficienti që shpreh sipërfaqen minimale të banimit që duhet të ketë një individ në banesë. Ky koeficient shprehet në sipërfaqe, në metër katror për individ.
(xiv) ''Komisioni i strehimit'' është Komisioni që ngrihet me vendim të këshillit të njësisë së vetqeverisjes vendore dhe ka në përbërje përfaqësues të komuniteteve të interesuara.
(xv) ''Të ardhura familjare'' janë të ardhura periodike që siguron familja nga pagat, veprimtaria ekonomike, pagesat që marrin pjestarërt e familjes që kujdesen për personin me aftësi të kufizuar, interesat e depozitave bankare, të ardhura nga personat e tretë, qiratë nga prona të paluajtshme.
(xvi) ''Strehim'' është tërësia e elementeve financiare, sociale dhe institucionale të proçesit të sigurimit të banesës.

Për realizimin e këtij programi është punuar në bashkëpunim me drejtoritë e tjera.

- DREJTORIA E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT, INVESTIMEVE, KONTROLLIT TË PROJEKTEVE, E SHËRBIMEVE PUBLIKE, STREHIMIT DHE TRANSPORTIT
- DREJTORIA JURIDIKE, PROKURIMEVE, PROTOKOLL - ARKIVËS, BURIMEVE NJERËZORE, DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
- SEKTORI I NDIHMËS EKONOMIKE, MROJTJES SË FËMIJËVE, BARAZISË GJINORE, DHUNËS, QENDRËS KOMUNITARE DHE MULTIFUNKSIONALE.
- SEKTORI I MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN
- ZYRA E GJENDJES CIVILE
- DREJTORIA E FINANCËS

PËRMBLEDHJE

Strehimi social në kontekstin evropian përkufizohet në lidhje me pronësinë, ofruesin e shërbimit, përfituesit dhe masat e financimit. Në kontekstin shqiptar dhe në kontekstin e strategjisë për strehimin social "*strehimi social është një alternativë strehimi që mund të ofrojë dhënien me qira ose përmirësimin e banesës, e cila ofrohet nga qeverisja vendore ose qëndrore për familjet me të ardhura të ulëta që nuk mund të blejnë një shtëpi me çmimet e tregut dhe/ose për familjet e përjashtuara nga tregu i banesave për shkak të pozitave të pafavorizuara që çojnë në përjashtim. Financimi ofrohet nga qeverisja qendrore dhe mund të plotësohet nga buxhetet e qeverisjes vendore.*

Një nga pengesat kryesore për hartimin e politikave dhe programeve efektive të strehimit social është mungesa e të dhënave sistematike dhe analizave të cilat mbështeten në të dhëna.

Si pari, njësitë vendore nuk kanë një sistem të qëndrueshëm që u shërben për grumbullimin e të dhënave.

(2) përmirësimin e kuadrit ligjor, institucional, dhe rregullator;
(3) fuqizimin e instrumenteve financiare për grupet në pozita të pafavorizuara; dhe
(4) zgjerimin dhe riorientimin e programeve të strehimit social.

BAZA LIGJORE

Në mbështetje të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës, nenit 8 pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja "b", nenit 24, nenit 54 shkronja "k", nenit 55, pikat 2 dhe 6, të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, ligjit nr.22/2018, "Për strehimin Social" ; VKM nr. 361 datë 29.05.2019 "Për përcaktimin e procedurave të zhvendosjes së individëve/familjeve nga vendbanimi i tyre i strehimit, në rastet e parashikuara në ligj dhe bashkëpunimit institucional"; Vendimit nr. 362, datë 29.05.2019 të Këshillit të Ministrave "Për kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë"; Vendimit nr. 384, datë 12.06.2019 "Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të srehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore"; VKM nr.334 datë 12.06.2019 ''Për Përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të proçedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore''; VKM nr. 873, datë 11.11.2020 '' Për përcaktimin e rasteve dhe të mënyrës së bashkëpunimit , ndërmjet pushtetit qëndror e njësive të vetëqeverisjes vendore, për krijimin ose shtimin e fondit publik të banesave sociale; VKM nr. 459, datë 03.07.2019 ''Për rregullat për administrimin e kërkesave të njësive të vetëqeverisjes vendore për fonde nga buxheti i shtetit për subvencionimin e qirasë ose uzufruktit, mënyrën e financimit të subvencionit, monitorimin dhe bashkëpunimin ndërmjet njësive të vetëqeverisjes vendore dhe ministrisë përgjegjëse për strehimin''; Vendimit nr. 53, datë 23.12.2022 të Këshillit Bashkiak "Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2023-2025 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Polican për vitin 2023", me propozim të Kryetarit të Bashkisë.

Në mbështetje të nenit 24 të ligjit 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" parashikohet se Bashkitë janë përgjegjëse për krijimin dhe administrimin e shërbimeve sociale, në nivel vendor, për shtresat në nevojë, personat me aftësi të kufizuara, fëmijët, gratë, gratë kryefamiljare, gratë e dhunuara, viktima të trafikut, nëna apo prindër me shumë fëmijë, të moshuarit etj., sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.

Në bazë të ligjit 22/2018 zbatimi dhe implementimi i programeve sociale të strehimit mund të bëhet nga organet e pushtetit qëndror dhe/ose nga njësitë e vetëqeverisjes vendore .

Në nenin 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja "a"' të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar (në vijim referuar si "Ligji 139/2015"), përcaktohet se: "*Njësitë e vetëqeverisjes bazuar në Kushtetutë, në ligje dhe aktet nënligjore, të nxjerra në bazë dhe për zbatim të tyre, për kryerjen e funksioneve dhe ushtrimin e kompetencave, nxjerrin urdhëresa, vendime dhe urdhra*".

Sipas nenit 24 të Ligjit 139/2015 të ndryshuar, njësitë e qeverisjeve vendore ushtrojnë funksionet e tyre në fushën e shërbimeve sociale. Njësitë e qeverisjeve vendore janë përgjegjëse për kryerjen e këtyre funksioneve nëpërmjet "*... krijimit dhe administrimit të shërbimeve sociale, në nivel vendor, për shtresat në nevojë, personat me aftësi të kufizuara, fëmijët, gratë, gratë kryefamiljare, gratë e dhunuara, viktima të trafikut, nëna apo prindër me shumë fëmijë, të moshuarit etj., sipas mënyrës së përcaktuar me ligj...*" si dhe nëpërmjet "*... krijimit, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për mirëqenien sociale, të fondit social për financimin e shërbimeve, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj*".

Ligji nr. 22/2018,"Për strehimin social", ka për objekt të tij administrimin dhe shpërndarjen së programeve sociale për strehimin, me qëllim krijimin e mundësive për strehim të përshtatshëm dhe të përballueshëm, duke u mbështetur në aftësitë paguese të familjeve që kanë nevojë për strehim, si dhe referuar nenit 15, pika 5 të po këtij ligji përcaktohet se lista e përfituesve dhe dokumentacioni përkatës për përftimin nga programi i bonusit të strehimit vlerësohet nga Komisioni i Strehimit dhe miratohet nga këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore.

Me vendimin nr. 384, datë 12.6.2019 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore", janë përcaktuar dokumentacioni dhe procedurat me qëllim përfitimin e programeve sociale të strehimit.

➢ PËRMBAJTJA E PROGRAMIT 5-VJEÇAR TË STREHIMIT.

Programi i strehimit synon të krijojë një pamje të qartë të situatës apo gjendjes aktuale në të cilën ndodhen individët të cilët banojnë në Bashkinë Poliçan, duke përmbajtur dhe gjithë punën e kryer nga ana e institucionit tonë apo angazhimin që parashikon bashkia në 5 (pesë) vitet e ardhshme për zgjidhjen e problemeve lidhur me strehimin e familjeve në nevojë.

Neni 68 i Ligjit 22/2018 "Për Strehimin Social" shprehimisht thuhet se: Strukturat përkatëse të njësisë së vetëqeverisjes vendore hartojnë programe 5-vjeçare strehimi për popullsinë nën juridiksionin e tyre, duke u mbështetur në analizën e nevojave për strehim dhe në përputhje me strategjinë e strehimit social, sipas parashikimeve të këtij ligji. Ky program miratohet nga këshilli i njësisë të vetëqeverisjes vendore.
Referuar ligjit të strehimit, aktualisht mund të aplikohen disa programe sociale strehimi:

a) programi i banesave sociale me qira/subvencioni i qirasë;
b) programi për përmirësimin e kushteve të banesave ekzistuese, deri në një ndërtim të ri;
c) programi i banesave me kosto të ulët, në vijim BKU;
ç) programi për zhvillimin e zonës me qëllim strehimi;
d) programi për krijimin e banesave të përkohshme;
dh) programi i banesave të specializuara.

1. Programi 5-vjeçar i Strehimit Social do të përmbajë:

a) burimet e financimit, që përfshijnë fonde nga buxheti i shtetit, fondet e siguruara nga vetë njësia e vetëqeverisjes vendore, donatorët si dhe fonde nga burime të tjera të mundshme;
b) përfitimi nga subvencioni i qirasë, përfituesit, kushtet që duhe të plotësohen dhe mënyra se si do të bëhët aplikimi për të qënë përfitues.
c) nevojat për strehim, sipas parashikimeve të këtij ligji, duke përcaktuar grupet e familjeve sipas të ardhurave dhe gjendjes së tyre sociale;
d) numrin e familjeve që do të përfitojnë nga subvencioni i qirasë dhe përmirësimi i banesave ekzistuese periodikisht gjatë periudhës 5(pesë) vjeçare dhe mënyrat e bashkëpunimit me sektorin privat;
e) masën e subvencionimeve nga buxheti i shtetit dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore në ndihmë të përfituesve për shlyerjen e qirave.

3. ***Hartimi i programit 5-vjeçar të strehimit ka si qëllim:***

- Uljen e varfërisë në Bashkinë Poliçan;
- Të krijohet modeli i një qeverisje vendore moderne dhe efektive në përmirësimin e kushteve të jetesës së banorëve të saj;
- Përmirësimin e cilësisë së jetesës së qytetarëve të saj duke iu mundësuar banesa dinjitoze për strehim;
- Të përmirësohet cilësia e shërbimit ndaj qytetarëve;
- Barazi ndërmjet qytetarëve të të gjitha njësive administrative të saj.
- Kosto efektive-përdorimi i burimeve ekzistuese në mënyrë efikase pa investuar në burime të tjera
- Mbështetje-duke siguruar mirëmbajtjen për një kohë të gjatë të një aseti fizik ose projekti nëpërmjet promovimit, përmirësimit të dialogut mes aksionerëve.
- Zhvillim institucional-ngritje të kapacitetve të veta duke mësuar nga të tjerët (planifikim, koordinim, trajnim)
- Zhvillim të nivelit të shoqërisë-vënien në zbatim të skemave të investimeve të vogla ose mobilizim të burimeve të qytetarëve me institucione të ndryshme qeveritare.

4. ***Drejtorisë përkatëse pranë Bashkisë Poliçan i lind nevoja të hartojë një udhëzues për mënyrën e funksionimit të përfitimit nga programi i strehimit social, mbështetur në arsyetimin si më poshtë vijon:***

- Unifikimi i procedurave që do të ndiqen midis strukturave të Bashkisë Poliçan, me qëllim krijimin e lehtësirave të nevojshme për aplikimin në këtë program social strehimi.
- Numri i madh i aplikimeve për bonus strehimi, të cilat, tashmë, si rezultat i miratimit dhe zbatimit të reformës territoriale-administrative, dërgohen edhe nga dy njësitë e reja administrative të Bashkisë Poliçan Poliçan.
- Afati i gjatë kohor në skemën e përfitimit të bonusit të strehimit të familjeve përfituese në vitet 2023-2028.
- Domosdoshmëria e vlerësimit socal - ekonomik paraprak të familjeve të cilat aplikojnë për t'u trajtuar me Subvencion Qiraje dhe Përmirësimin e Banesave ekzistuese.

5. **Prioritetet e programit social.**

Në mbështetje të ligjit 22/2018 "Për Strehimin Social", Bashkia Poliçan konsideron si prioritet të sajin në këtë program subvencionimin e qirasë së banesave dhe përmirësimin e banesave ekzistuese për qytetarët të cilët kanë kërkuar të trajtohen sipas programeve të parashikuara në këtë ligj. Këtyre familjeve do tu ofrohet mundësia për të pasur një banesë me kushte dinjitoze dhe të përshtatshme jetese.

Duke u mbështetur në planin 5-vjeçar, Bashkia Poliçan ka si qëllim të krijojë një model të suksesshëm të bashkëpunimit midis sektorit publik dhe atij privat, ku prioritet do të ketë zgjidhjen e problemit të strehimit me interes të komunitetit. Sipas ligjit Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Vetëqeverisja vendore në Republikën e Shqipërisë siguron qeverisjen e efektshme, efikase dhe në një nivel sa më afër qytetarëve nëpërmjet:

a) zgjedhjes së llojeve të ndryshme të shërbimeve dhe lehtësive të tjera publike vendore në dobi të bashkësisë;
b) ushtrimit efektiv të funksioneve, kompetencave dhe realizimit të detyrave nga organet e vetëqeverisjes vendore;

Kategoria e parë:

- Familjet me rrezik shembje___ 5 (NJATerpan) 1 (Nj A Vertop), 10 (Polican)
- Familjet të cilat jetojnë në ambiente publike, shkolla, kopështe, ish spital, baraka dhe bodrume__6 familje prej 2 anëtarësh
- Familjet e pastreha___150
- Familjat qiramarrëse në banesa private___6
- Familje të pastreha si rezultat i privatizimit të banesave shtetërore.....0
- Familjet e komunitetit egjiptian 42

7. Kriteret e përzgjedhjes së përfituesve

Njësia e vetëqeverisjes vendore, në përzgjedhjen e individëve/familjeve përfituese, për hartimin dhe miratimin e sistemit të pikëzimit bazohet në kriteret e mëposhtme:

a) Kushtet e strehimit, në bazë të të cilave përcaktohen me përparësi familjet që:
i) nuk disponojnë banesë në pronësi;
ii) banojnë në banesa që paraqesin rrezik shembjeje;
iii) banojnë në banesa të mbipopulluara, sipas përcaktimeve dhe normave në fuqi;
iv) kanë mbetur ose rrezikojnë të mbeten të pastreha, si rezultat i fatkeqësive natyrore;
v) familjet ose individët që humbasin banesën e tyre, si pasojë e zhvendosjes ose zbatimit të një vendimi gjyqësor;
vi) banojnë në banesa që prishen ose përjashtohen nga procesi i legalizimit, si rezultat i investimeve publike.
b) Kushtet familjare, në bazë të të cilave përcaktohen me përparësi:
i) familjet njëprindërore që kanë në ngarkim fëmijë, ku përfshihen edhe vajzat nëna;
ii) të moshuarit, që kanë mbushur moshën e pensionit dhe që nuk përzgjidhen për t'u strehuar në institucionet publike të përkujdesjes shoqërore;
iii) familjet me më shumë se katër fëmijë;
iv) bashkëshortët, mosha e përgjithshme e përbashkët e të cilëve arrin deri në 60 vjeç.
c) Kushtet sociale, në bazë të të cilave përcaktohen me përparësi:
i) personat me aftësi të kufizuara, në përputhje me përcaktimet e bëra me vendim të Këshillit të Ministrave;
ii) individët me statusin e jetimit, që nga çasti i daljes nga qendrat e përkujdesjes shoqërore dhe deri në moshën 30 vjeç;
iii) familjet e mbetura të pastreha për shkak të lirimit të banesave ish-pronarëve;
iv) emigrantët e rikthyer, punëtorët emigrantë dhe azilkërkuesit;
v) familjet e policëve të rënë në detyrë;
vi) punonjësit e reparteve të ndërhyrjes së shpejtë (FNSH);
vii) punonjësit e repartit RENEA;
viii) punonjësit e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin;
ix) viktimat e dhunës në familje;
x) viktimat e trafikimit/viktimat e mundshme të trafikimit;
xi) anëtarët e komunitetit rom;

Kërkesat e aplikuesve të rinj, për përfitimin e subvencionimit, mund të paraqiten në çdo kohë gjatë vitit, por jo më vonë se muaji nëntor për vitin pasardhës. Të gjitha këto rregulla për administrimin e kërkesave të njësive të vetëqeverisjes vendore për fonde nga buxheti i shtetit mbi subvencionimin e qirasë, mënyrën e financimit të subvencionit, monitorimin dhe bashkëpunimin ndërmjet njësive të vetëqeverisjes vendore dhe ministrisë përgjegjëse për strehimin, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Pra do të ketë një bashkëpunim të vazhdueshëm ndërinstitucional në mënyrë që fondet për realizimin e pikave të këtij programi mos të mbeten thjesht të shkruara por të kemi përfitues në vazhdimësi nga këto programe që po paraqesim.

- ✓ **Qëllimi i miratimit të një Udhëzuesi për Subvencionin e Qirasë.**

- Unifikimi i procedurave që do të ndiqen midis strukturave të Bashkisë Poliçan , me qëllim krijimin e lehtësirave të nevojshme për aplikimin në këtë program social strehimi.
- Përshtatje me ndryshimet e reja ligjore.
- Numri i madh i aplikimeve për bonus strehimi, të cilat, tashmë, si rezultat i miratimit dhe zbatimit të reformës administrativo-territoriale, dërgohen edhe nga njësitë e reja administrative të Bashkisë Polican.
- Afati i gjatë kohor në skemën e përfitimit të bonusit të strehimit të familjeve përfituese ndër vite, duke filluar nga viti 2023.
- Domosdoshëria e vlerësimit socal-ekonomik paraprak të familjeve të cilat aplikojnë për t'u trajtuar me subvencionim të qirasë.

- ✓ **Historiku ndër vite mbi familjet përfituese të bonusit për subvencionimin e qirasë.**

Do të paraqesim tabelën me të dhënat statistikore të cilat janë nxjerrë nga Drejtoria e Planifikimit të Territorit, dhe nga Sekretaria e Këshillit Bashkiak, Bashkia Polican .

Përfituesit e Pagesës së Qirasë 2020- 2023 e në vijim

Nr	Emër Mbiemër i Përfituesit	Masa e qirasë në muaj	Masa totale
1	Vide Alimeti	7000	7000
2	Familja Bufi	5000	5000
3	Edmond Leka	5000	5000
4	Familja Agalliu	5000	5000
5	Gjylfiza Shahu	6000	6000
6	Xhevahir Shahu	6000	6000

- ✓ **Masa e subvencionit të qirasë së banesës.**

Subvencioni i qirasë iu shpërndahet me vendim të Këshillit Bashkiak, atyre familjeve të cilat kanë paraqitur kërkesën për strehim duke plotësuar formularin tip të strehimit dhe që përfitojnë pikët maksimale, sipas sistemit të pikëzimit të miratuar për këtë program sipas tabelës së mëposhtme.

F	I mitur në konflikt me ligjin	1
G	Komuniteti LGBTI, Viktima për shkak të orientimit seksual	3
GJ	Anëtar i familjes që trajtohet me ndihmë ekonomike	2
1.4	**KUSHTET EKONOMIKE**	**12**
A	Të ardhura nën 70% të të ardhurave mesatare	5
B	Të ardhura deri 70% - 100% të të ardhurave mesatare	4
C	Të ardhura 100%- 120% të të ardhurave mesatare	3

Në llogaritjen e pikëve për individët/familjet aplikuese, Komisioni i Strehimit duhet të marrë në konsideratë rregullat e mëposhtme:

Pikët maksimale që mund të përfitojë një individ/familje janë 100. Nuk mund të mblidhen brenda për brenda një kriteri pikët:

1. Nga A deri në Ç të kriterit 1.1 - Kushtet e strehimit;
2. Nga A deri në Ç të kriterit 1.2 - Kushtet familjare; dhe
3. Nga A deri në C të kriterit 1.4 - Kushtet ekonomike.

Pikët të kriterit 1.3 mund të mblidhen me njëra-tjetrën sipas rasteve më poshtë:

a) Pika A mund të mblidhet me njërin prej rasteve si më poshtë:
b) Me pikat B dhe Ç së bashku ose veçmas;
c) Vetëm me pikën C;
d) Vetëm më pikën D.

Pika B mund të mblidhet vetëm me pikën A.
Pika Ç mund të mblidhet me pikat A e B së bashku ose me njërën prej tyre.
Në total mbledhja e pikëve A, B e Ç nuk duhet të rezultojë më e lartë se 20 pikë.

Përparësi në subvencionimin e qirasë sipas sistemit të pikëzimit, por pa u kufizuar në to, kanë kategoritë e përcaktuara në ligjin 22/2018 "Për strehimin social" përfshirë dhe individët që dalin nga sistemi i përkujdesjes alternative si më poshtë:

a) individët me statusin e jetimit;
b) personat me aftësi të kufizuara;
c) të moshuarit;
ç) invalidët e punës;
d) familjet e policëve të rënë në detyrë;
dh) emigrantët e rikthyer;
e) punëtori emigrant;
ë) azilkërkuesit;
f) familjet e komunitetit rom;
g) familjet e komunitetit egjiptian;
gj) Viktimat e dhunës në familje;

Pagesa e subvencionit të qirasë i referohet nivelit të të ardhurave mujore të familjes dhe qirasë për të cilën është lidhur kontrata e qirasë. Kontrata e qirasë lidhet ndërmjet pronarit ose përfaqësuesit të autorizuar prej tij dhe, sipas rastit, individit përfitues ose, në rastin e familjeve, prej bashkëshortëve ose bashkëjetuesve, në bazë të dispozitave të Kodit Civil.

Shuma e vlerës së subvencionimit të qirasë llogaritet sipas formulës:

Formula e përgjithshme e llogaritjes së vlerës së subvencionimit të qirasë është:

S = Qr-A x Ap ku Qr</= Qm

a- S është vlera e subvencionit;
b- A janë të ardhurat e familjes;
c- Ap është aftësia përballuese e familjes, sipas nenit 3 të ligjit nr. 22/2018
ç- Qm është vlera mesatare e qirave të banesave në tregun e lirë, sipas pikës 36 të nenit 2 të këtij ligji;
d- Qr është qiraja reale e përcaktuar në pikën 35 të nenit 2 të ligjit 22/2018.

Vlera e subvencionimit të qirasë në tregun e lirë për një njësi të qeverisjes vendore të caktuar luhatet nga 0 deri në 100%, në varësi të të ardhurave të familjes. Për një vlerë qiraje Qr, vlerat maksimale dhe minimale të subvencionimit të strehimit, në varësi të të ardhurave të familjes llogariten sipas formulës së mësipërme.

Subvencioni i qirasë rinovohet çdo vit, sipas kontratës së qirasë dhe të ardhurave të deklaruara të familjes, sipas përcaktimeve në pikat 1, 2, 3 dhe 4, të nenit 29, të ligjit 22/2018 "Për strehimin social".

Afati i lidhjes së kontratës së qirasë nuk mund të jetë më i shkurtër se 1 vit.

Në rastet kur subjekti përfitues nuk e depoziton kontratën brenda afatit 1-mujor, komisioni shtyn afatin me 30 ditë. Nëse edhe pas këtij afati shtesë subjekti përfitues nuk depoziton kontratën, ai humbet të drejtën për të vijuar procedurën. Subjekti ka të drejtë të aplikojë përsëri në përputhje me procedurat e parashikuara në këtë ligj.

Familja që ka përfituar subvencionin e qirasë mund të dalë nga kjo skemë pas një viti, nëse vërtetohet që ajo ka zgjidhur problemin e strehimit, ose nëse të ardhurat e familjes janë rritur mjaftueshëm për të përballuar pagesën e qirasë pa nevojën e bonusit, dhe skualifikohen sipas metodikës së përllogaritjes së qirasë.

Çdo familje e cila është miratuar me vendim të Këshillit Bashkiak, pajiset me një skedë personale, e cila do të përmbajë:

a) të dhëna mbi identifikimin e qiramarrësit;
b) të dhëna mbi identifikimin e qiradhënësit;
c) adresën e banimit aktual të qiramarrësit;
d) adresën e banesës që jepet me qira;
e) adresën e banimit të qiradhënësit, nr.telefoni apo çdo të dhënë tjetër që mund të shërbejë për të komunikuar me të në rast ndërprerje të bonusit;
f) të dhëna të mjaftueshme për të kontaktuar me qiramarrësin;
g) shumën e bonusit që përfiton qiramarrësi në muaj;
h) vitin apo periudhën gjatë të cilit është i vlefshëm bonusi;
i) masa sigurie, në mënyrë që të mos lejojë falsifikimin e tij.

Sektori i Ndihmës Ekonomike, , realizon proçesin e seleksionimit të formularëve të vlefshëm sipas akteve ligjore dhe nënligjore që rregullojnë fushën e strehimit social.

Pas seleksionimit bëhet regjistrimi i tyre në sistemin elektronik të drejtorisë dhe harton listën paraprake të familjeve të cilat në bazë të të dhënave të plotësuara në formular dhe mbështetur në vetëdeklarimin e aplikuesit, ku rezulton se ata plotësojnë kushtet e përcaktuara në pikat 1, 2, 3 e 4, të nenit 13, të ligjit nr. 22/2018, "Për strehimin social".

Në qoftë se kërkesa e aplikantit ka të meta dhe mangësi të të dhënave të kërkuara nga ky vendim, struktura përgjegjëse për strehimin, brenda 7 ditëve pune nga dita e regjistrimit të kërkesës, njofton aplikantin/kërkuesin për pasaktësitë, dhe i kërkon me shkrim aplikantit tí korrigjojë ato. Kur kërkuesi nuk plotëson pasaktësitë brenda afatit të caktuar, kërkesa quhet se nuk është regjistruar dhe i kthehet aplikantit.

Sektori i shërbimit social në bashki, në bashkëpunim me Drejtorinë e planifikimit të territorit dhe Njësitë Administrative**, brenda 7 shtatë ditëve kalendarike nga momenti i depozitimit të Formularëve nga Njësitë Administrative,** njofton aplikuesit që përmbushin kriteret për të përfituar subvencionimin e qirasë, si dhe ato që nuk mund të përfitojnë. Të dyja kategoritë, si përfituesit dhe ata që nuk janë përfitues do të njoftohen nëse i kanë përmbushur kriteret për të qenë përfitues apo jo.

Drejtoria përkatëse do të njoftojë çdo familje e cila nuk shpallet përfituese e fazës së parë, përmes shkresë zyrtare duke sqaruar arsyen e mos shpalljes fitues.

Njoftimi (shkresa) do t'i drejtohet njësisë administrative ku aplikuesi ka realizuar plotësimin e formularit, duke vendosur në dijeni edhe qytetarin që ka aplikuar.

Familjet që rezultojnë të sukseshme në fazën e parë të aplikimit, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga momenti i njoftimit, dorëzojnë dokumentacionin e nevojshëm që vërteton deklarimin dhe vërtetësinë e plotësimit të formularit, në bazë të të cilit janë përzgjedhur fitues.

2. Faza e dytë e aplikimit:

1. Familjet që rezultojnë të sukseshme në fazën e parë të aplikimit, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga momenti i njoftimit, paraqesin pranë Drejtorinë e planifikimit të territorit dhe dorëzojnë dokumentacionin e nevojshëm të përcaktuar në VKM nr. 384 date 12.06.2019 "Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit, dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëvetëqeverisjes vendore", si më poshtë:

a. Për të dhëna personale të aplikantit:

i. çertifikata e lindjes së aplikantit, me përjashtim të rasteve specifike kur individi/familja nuk ka regjistrim në gjendjen civile;
ii. vërtetimi për vendbanimin në njësinë e vetqeverijes vendore ku kërkohet strehimi social, për familjet që kanë lëvizur nga zona të tjera të vendit;

b. Për vërtetimin e kushteve të strehimit, sipas shkronjës (a) të nenit 16 të ligjit nr. 22/2018 "Për strehimin social":

i. vërtetimi nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme për pronat që disponohen në emër të secilit anëtar të familjes;

v. vërtetimi nga organet e sigurimeve shoqërore për personat në pension.

Ndër të tjera për të vërtetuar situata të caktuara është e nevojshme përpos listës së mësipërme të paraqiten edhe dokumentat si më poshtë vijon:

1. Vërtetimi nga zyra përmbarimore për masën e pensionit ushqimor që përfiton sipas vendimit të gjykatës.
2. Pasqyra financiare për vitin kalendarik të shkuar për personat e vetëpunësuar e njehsuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore. Ekstrakt historik nga QKB.
3. Vërtetimi nga zyra e punësimit e njësisë vendore përkatëse për personat të cilët janë regjistruar si persona punëkërkues të papunë;

Dokumentacioni tjetër i parashikuar në pikën 17 të këtij vendimi, që mbajnë apo përgatisin organet publike në vend, sigurohet nga Njësitë Adminsitrative përkatëse duke përjashtur aplikantin nga detyrimi për paraqitjen e tyre, vetëm nëse aplikanti depoziton *deklaratën e pëlqimit* për mbledhjen e informacioneve/dokumenteve të lidhura me të, sipas formatit tip që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Nëse aplikanti nuk e dorëzon apo refuzon të firmosë këtë deklaratë, Njësia Administrative/Lagjet shkarkohen nga detyrimi i mbledhjes së dokumentacionit dhe ky detyrim i kalon vetë aplikantit.

Dorëzimi i dokumentacionit nga vetë aplikanti në rastet kur nuk kanë plotësuar deklaratën e pëlqimit për mbledhjen e dokumentacionit, do të realizohet pranë Sektorit të Informimit dhe Shërbimeve për Qytetarët. Në rast se dita e fundit e këtij afati bie e shtunë, e diel ose një ditë feste zyrtare, afati mbaron në ditën e punës që vjen pas saj.

Çdo praktikë e dorëzuar do të shoqërohet *me inventarin e dokumentacionit të dorëzuar* e firmosur nga personi përgjegjes i cili pranon dokumentat si dhe aplikanti. Çdo praktikë duhet të përmbajë të gjitha dokumentat sipas përbërjes familjare të aplikuesit dhe në rastin kur dokumentacioni nuk rezulton i plotë pas vlerësimit nga DSS, njofton Njësinë Administrative përkatëse dhe aplikuesin për mungesat në dokumentacion.

Për efekt të zbatimit të këtij udhëzuesi, do të konsiderohen të vlefshme dokumentet që janë lëshuar nga institucionet kompetente, jo më vonë se 3 (tre) muaj nga data e përcaktuar për mbledhjen e Komisionit të Strehimit.

Seleksionimi i formularëve dhe dokumentacionit :

Drejtoria e Planifikimit të Territorit dhe Strehimit seleksionon dhe vlerëson paraprakisht dokumentacionin e dorëzuar nga aplikuesit, brenda 10 dhjetë ditëve kalendarike.

3. Shqyrtimi dhe vlerësimi i dokumentacionit nga Komisioni i Strehimit

Drejtoria e Planifikimit të Territorit, vendos në dispozicion të Komisionit të Strehimit të gjithë formularët e seleksionuar si të vlefshëm gjatë fazës së parë të shqyrtimit, shoqëruar me të gjithë dokumentacionin e dorëzuar nga aplikuesit.

Çdo formulari do t'i bashkëlidhet edhe "Lista e inventarit" (e cila përmban të gjithë dokumentacionin e dorëzuar nga aplikuesit dhe i nëshkruar nga nëpunësit e autorizuar të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve Sociale.

përfitues depoziton pranë Komisionit të Strehimit kontratat e qirasë të lidhura ndërmjet tij dhe pronarit social.

Në rastet kur subjekti përfitues nuk e depoziton kontratën brenda afatit 1-mujor, komisioni shtyn afatin me 30 ditë. Nëse edhe pas këtij afati shtesë subjekti përfitues nuk depoziton kontratën, ai humbet të drejtën për të vijuar procedurën. Subjekti ka të drejtë të aplikojë përsëri në përputhje me procedurat e parashikuara në këtë ligj.

Vënia në zbatim e këtij udhëzuesi të përfitimit të bonusit të strehimit, do të udhëhiqet nga Sektori i Shërbimeve Sociale, në bashkëpunim me strukturat e listuara si më poshtë vijon:

- *2 Njësitë Administrative të Bashkisë Polican*
- *Drejtorinë e Financave*
- *Drejtorinë Juridike,*
- *Sektori*
- *Marrëdhënieve me Publikun*

8. Për çështje specifike të cilat nuk janë trajtuar në këtë udhëzues standart, do të jenë të zbatueshme parashikimet e akteve ligjore dhe nënligjore, në fushën e Strehimit Social.

9. Shtrirja Gjeografike

Programi synon të përfshijë dhe mbështesë të gjithë individët dhe familjet që individët dhe familjet që kanë vendbanim në territorin e Bashkisë Tiranë.

II. PËRMIRËSIMI I BANESAVE EKZISTUESE

- **Familjet në nevojë në Bashkinë Polican .**

Bashkia Polican, ndër vite është përpjekur të qëndrojë pranë problematikave të qytetarëve të saj duke dërguar në mënyrë sistematike specialist në terren për të verifikuar situatat konkrete.

Në hapat e saj lidhur me përmirësimin e jetës së banorëve të saj, ka ndërmarrë prej vitesh projekte apo programe lidhur me ndihmat ekonomike për personat me të ardhura të ulëta apo pa të ardhura, gjithashtu edhe me programet për përmirësimin e banesave ekzistuese.

Në planin 5-vjeçar të strehimit , Bashkia Polican, synon ta përmirësojë akoma më shumë sistemin e ofrimit të ndihmave në forma të ndryshme. Përpjekjet vijojnë në proporcion edhe me kushtet apo mundësitë që ka bashkia në terren për të ndihmuar banorët e saj. Me anë të këtij projekti synohet të ofrohen programe konkrete, të cilat kanë vijuar më shpesh dhe në mënyrë sistematike nga ana jonë.

Bazuar në nenin 42 të Ligjit 22/2018 ''Për Strehimin Social'' me përmirësimin e kushteve të banesave ekzistuese private ose pronë shtetërore nënkupton ndihmën që u jepet, me grante konkurruese, njësive të

shumicën e popullsisë. Një kategori mjaft inferiore ndër vite në shoqërinë tonë, sipas investigimeve që janë bërë në terren për situatën aktuale të strehimit në Njësitë tona Administrative, është verifikuar se ka mungesa të theksuara të kushteve normale të jetesës.

Nga ky aspekt, dalim në përfunimin se kjo kategori e popullsisë ka nevoja të menjëhershme për vënien dorë nga ana e bashkisë për banesat e tyre ekzistuese. Jetesa në këto kushte, nën normën mesatare na jep në shtysën për të vijuar me programin për përmirësimin e kushteve ekzistuese te objekteve.

Egjiptianët në Shqipëri nën ndikimin e faktorëve socio-ekonomikë kanë patur një rritje më të madhe të popullsisë në krahasim me popullsinë në shumicë. Vajzat martohen në moshë shumë të re dhe bëhen nëna më shpejt se grupet e tjera etnike. Këto karakteristika formësojnë edhe problematika që lidhen me zhvillimin, regjistrimin dhe aksesin në të drejta të këtij komuniteti. Sipas të dhënave zyrtare, komuniteti rom dhe egjiptian zë 0.96% të popullsisë totale të regjistruar brenda bashkisë Polican .
Në Bashkinë Poliçan komuniteti egjiptian janë të përqendruar kryesisht në njësinë administrative Vërtop. Aktualisht në bashkinë Poliçan jetojnë një numër prej 50 banorë të komunitetit egjiptian. Eshtë komunitet i varfër, si në qytet ashtu edhe në fshat. Problematikat e këtij komuniteti janë të shumta.

Nga evidentimi i situatës në terren rezulton se këto familje kanë objekte (banesa) të palegalizuara, por problematikën më të madhe e kanë me dokumentacionin teknik e ligjor (çertifikatë pronësie) për truallin.

Problem madhor është niveli i lartë i papunësisë. Për pasojë ky komunitet përpiqet të migrojë jashtë vendit, kryesisht në Greqi dhe Itali si një nga mekanizmat kryesorë për përballimin e varfërisë dhe përjashtimit social.

Gjendja shëndetësore e anëtarëve të këtyre komuniteteve ndikohet jo vetëm nga aksesi i ulët në shërbime, por edhe nga parakushtet për një shëndet të mirë, si kushtet e banesës dhe ato higjenosanitare. Një numër i vogël i këtij komuniteti përfiton nga shërbimet sociale. Një sërë faktorësh, si gjendja e vështirë ekonomike, kushtet e papërshtatshme të banesave, kequshqyerja, burime të paqëndrueshme të të ardhurave dhe niveli i ulët arsimor e aksesi i ulët shëndetësor ndikojnë drejtpërsëdrejti në mirëqënien e këtyre komuniteteve duke rritur më shumë hendekun e integrimit socio-ekonomik me popullsinë në shumicë.

Gjthashtu, në bashki nuk ndeshen probleme lidhur me regjistrimin civil. Fëmijët egjiptianë ndjekin të njëjtin program edukimi, por nuk ka të dhëna cilësore mbi nivelin e edukimit (psh. nota mesatare).

- ✓ **Metodologjia e përdorur për realizimin e Planit të Strehimit për komunitetin Rom dhe egjiptian.**

Për hartimin e Planit të Strehimit është përdorur një kombinim i metodologjisë kërkimore sasiore dhe cilësore duke u bazuar edhe në të dhënat parësore dhe dytësore nga institucionet respektive në Bashkinë Poliçan. Metodologjia kërkimore përfshin:

1) Intervista gjysëm të strukturuara ballë për ballë me anëtarë të komunitetitEgjiptian;
2) Intervista të thelluara me informantë kyç nga institucionet vendore dhe shoqëria civile;

Kategoria e dytë:

3. Familjet të cilat jetojnë në ambiente publike, shkolla, kopështe, baraka dhe bodrume: 6 (gjashte
4. Familjet e pastreha___150
5. Familjat qiramarrëse në banesa private___6

Situata për Kategorinë e parë:

1.Ligji 22/2018 "Për Strehimin Social" trajton programin e përmirësimit të kushteve të banesave ekzistuese, i cili nënkupton ndihmën që u jepet me grante konkurruese njësive të vetëqeverisjes vendore nga buxheti i shtetit, për këtë qëllim. Banesat që trajtohen nga programi i përmirësimit të kushteve ose i përmirësimit të kushteve deri në ndërtim të ri janë banesat e amortizuara që kanë nevojë për ndërhyrje dhe përmirësime të domosdoshme, banesat në rrezik shembjeje etj.

Ky program ka për qëllim që t'u vijë në ndihmë familjeve në nevojë që banojnë në banesa të amortizuara apo në rrezik shembjeje, duke përmirësuar kushtet e banimit në banesat e amortizuara dhe duke realizuar ndërtim të ri për ato banesa që janë në rrezik shembjeje. Struktura përkatëse në njësinë e vetëqeverisjes vendore ngarkohet me detyrën për të identifikuar ndërhyrjet për përmirësimin e kushteve të banesave ekzistuese.

Një tjetër risi që adresohet në Ligjin 22/2018 "Për Strehimin Social" që ndikon në krijimin e fondit publik të banesave sociale është posaçërisht edhe programi për përmirësimin e kushteve të objekteve ekzistuese ose të përmirësimit të kushteve deri në një ndërtim të ri, konkretisht për:

a) objektet/banesat në rrezik shembjeje;

b) objektet/banesat e amortizuara që kanë nevojë për ndërhyrje dhe përmirësime të domosdoshme.

Një nga programet e strehimit social është dhe përmirësimi i banesave ekzistuese për komunitetet e varfëra dhe të pafavorizuara. Në planin 5 vjeçar të strehimit social do të përfshihen dhe personat që nuk disponojnë pronësi. Mbështetur në analizën deri në fund të vitit 2022 rezultoi se familjet objektet të cilëve ishin në rrezik shëmbje ishin 16, ku këtu përfshihen objekte të cilat janë dëmtuar nga tërmetet në vitet 2019, dhe objektet e komuniteteve te varfëra dhe të pafavorizuara, të cilët nuk kanë mundësi ekonomike për përmirësimin e kushteve të banesave ekzistuese ku një pjesë e tyre janë të amortizuara totalisht.

Nisur nga kërkesa çdo fillim viti e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, mbi fondet për projektet e strehimit, për vitin 2023 kemi bërë aplikimin për përfitim të fondeve për 15 familje.

Në bashkëpunim me zyrën e ndihmës ekonomike, administratorët e njësive administrative, kërkesave të bëra nga vetë familjet në zyrën përkatëse të njësisë së vetëqeverisjes vendore të vendbanimit/vendqëndrimit, evidentimit dhe matjeve në vend, hartuam edhe planin e ndërhyrjes për përmirësimin e kushteve të këtyre objekteve ekzistuese.

Vlera e preventivit të punimeve u hartua në përputhje me kriteret e përcaktuara në shtojcën A, përfshirë në termat e referencës, ku përcaktohen kufijtë e financimit si një nga kriteret kryesore për aplikim.

Si synim është përmirësimi i kushteve ekzistuese të jetesës, nësë është e nevojshme edhe me anë të një ndërtimi të ri. Do të kryhet tërësia e punimeve me qëllim që banesa të shndërrohet në një strehim të përshtatshëm, sipas kushteve të parashikuara në nenin 4 të këtij ligji.
Objektet ose banesat që do të përfshihen në programin e strehimit të përmirësimin e kushteve ose përmirësimit të atyre ekzistuese janë:

a. Objektet/banesat në rrezik shembje.
b. Objektet/banesat e amortizuara, që kanë nevojë për ndërhyrje apo përmirësime të domosdoshme.

Për këtë komunitet është bërë aplikimi për 15 familje për përmirësimin e kushteve të këtyre banesave.
Në planin 5 vjeçar të strehimit social do të përfshihen dhe personat që nuk disponojnë pronësi. Familjet rome jetojnë kryesisht në vendbanime informale, në troje që nuk u përkasin atyre ose në toka me pronësi të diskutueshme, në shtëpi pa dokumenta pronësie. Të dhënat për pronësinë janë kontradiktore dhe të paplota.

Mungesa e pronësisë dhe jetesa në vendbanime informale i ka bërë këto komunitete të jenë më të ekspozuar nga zhvendosjet, dëbimet apo të mos kompensimit, si rezultat i ndërtimit të objekteve publike, etj. Zhvendosjet dhe dëbimet shoqërohen me një mori problemesh sociale si:

- mbetja të pastrehë;
- tensione;
- humbje të punës;
- probleme me arsimimin e fëmijëve;
- humbje të lidhjeve shoqërore dhe të lidhjeve me komunitetin.

❖ **Programet e tjera të strehimit**

Programet të cilave po i referohemi bazuar në ligjin për strehimin nuk janë një listë shteruese. Momentalisht, duke u bazuar në kërkesat dhe nevojat e qytetarëve, këto programe strehimi po zbatohen pranë Bashkisë Polican dhe lind e drejta për të pasur një plan strehimi konkret pikërisht për këto mundësi që ofrohen. Normalisht vitet kalojnë dhe nevojat e individëve janë të ndryshueshme dhe programet e strehimit vijojnë të japin rezultatet e tyre në momentin që lind nevoja për një kategori të caktuar të popullsisë.

Bashkia Polican zbaton me përpikmëri Ligjin Për Strehimin dhe është në gadishmëri për të qënë në mbrojtje të interesave të qytetarëve për çdo nevojë. Programet e strehimit mbeten gjithmonë të hapura për të shërbyer në përmbushjen e nevojave të banorëve të gjitha njësive administrative. Programet e mësipërme të strehimit, do të zbatohen nga ana e institucionit dhe në çdo kohë do të ketë përshtatje të programeve sociale me kushtet e vazhdueshme të jetesës dhe strehimit të personave që jetojnë në Bashkinë Polican .Bashkëlidhur materialit, modele të Formularit Tip të aplikimit.

KRYETARI BASHKISË
ADRIATIK ZOTKAJ

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POLICAN

Formular 2

Formati Tip i Vlerësimit Social-Ekonomik

Formular Vlerësimi Social- Ekonomik	
• INFORMACION BAZË PËR PËRFITUESIN	
Data e plotësimit të formularit:	
A1. Emri Mbiemri i rastit që referohet:	A8.Statusi Civil
A2.Data e lindjes:	A9.Profesioni
A4. Vendlindja/Vendbanimi (fshati/qyteti)	A10.Nr. i fëmijëve
A5. Origjina etnike (Rom/Egjiptian/Mix)	A11.Adresa ku banon
A6. Përfituesi jeton me	A12.Persona me aftësi të kufizuar
A7. Nr. i kontratës së banesës me qira	A13.Telefoni:
B. INFORMACION PËR KUSHTET SOCIAL EKONOMIKE TË PËRFITUESIT (Rrethoni alternativat te cilat I pershtaten familjes)	
- Familje gjithsej me 1 anëtar - Familje gjithsej me 2 anëtar - Familje gjithsej me 3 anëtar - Familje gjithsej me 4 anëtar - Familje gjithsej me 5 anëtar - Familje gjithsej me 6 anëtar - Familje që kanë në përbërje - Familje që kanë në përbërje ROM - Kryefamiljare gra - Jetim deri në 18 vjec - Jetim deri 25 vjec - Trinjakë - Katërnjakë - Pesënjakë - Viktimat e dhunës - Viktima të trafikimit - Fëmijë normal me shërbim kujdestarie - Fëmijë AK me shërbim kujdestarie - Familjeve në ndihmë ekonomike - Familjeve me anëtarë me PAK	
B1. Ambienti ku jeton përfituesi: (Përshkruaj me detaje ambientin ku jeton personi i identifikuar, shtëpinë sa dhoma ka, tualeti, korridori, sa katëshe është banesa me çfarë	

Formular 3

Aplikim për programin e Bonusit të Qirasë

Emri	
Atësia	
Mbiemri	
Vendlindja	
Ditëlindja	
Gjëndja civile	
Vendbanimi	
Kombësia	
Status i veçantë	
Të ardhurat e familjes	
Vlera e Qirasë që paguan	
Masa e bonusit që përfiton	_____lekë në muaj sipas formules ne ligjit S = Qr-AxAp ku Qr</ëQm
Masa e bonusit sipas zonës	
Vlera e qirase qe propozohet	

Profil i aplikuesit

(*Shpjego me fjalë kush është përfituesi, moshën, historikun nëse është përsëritës ose jo dhe arsyet përse eëhtë trajtuar më parë. Statusin e veçantë nëse ka. Në rast se nuk ka një status të veçantë shpjego arsyet që e nxitën të aplikojë për bonusin e qirasë. Marrëdhënia me pronarin social*)

Norma e strehimit

Aplikuesi	Nr. i anëtarëve të familjes	Norma minimale e strehimit	Normat e strehimit sipas kontratës

Inventari i Dokumentacionit

Në bazë të VKM Nr. 574, datë 29.8.2012 "Për përcaktimin e dokumentacionit që duhet të paraqesë familja për t`u strehuar sipas njërit prej programeve sociale të srehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e qeverisjes vendore"; Udhëzimit Nr. 23, datë 30.12.2008 për "Përmbajtjen e bonusit të strehimit" ……kemi pranuar me shkresen nr..... të ardhur në Bashkinë Dimal me dt... dhe deleguar Drejtorisë së Strehimit më datë....

Nr. Rendor	Emërtimi i Shkresës	Nr. prot për dokumentin	Nr. i fletëve	Nr. progresim

Formular 4 **DEKLARATË PËR DHËNIEN E PËLQIMIT PËR LEJEN PËR MARRJEN E DOKUMENTACIONIT PËR FAZËN E DYTË TË APLIKIMIT**

D E K L A R A T Ë

PËR

DHËNIEN E PËLQIMIT PËR MBLEDHJEN E TË DHËNAVE, AKSESIN PËR NJOHJEN DHE ADMINISTRIMIN E TË DHËNAVE PERSONALE

Unë, i biri i/e bija e dhe i/e, lindur më _____ , në_____ , dhe banues/banuese në _____, me shtetësi _____, me numër identifikimi_____, me vullnetin tim të lirë,

DEKLAROJ SE:

Mbështetur dhe në zbatim të:

Pikës 16, të vendimit nr._____, datë _____, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit, dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore";

- pikës 3, të nenit 14, të ligjit nr. 22/2018, "Për strehimin social";
- të neneve 2, 5 e 10, të ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale",

	Deklarimi	Firm (në kutinë që aplikanti dëshiron të plotësojë)
	- Jap pëlqimin që të mblidhen të dhënat e nevojshme, sipas parashikimeve tëpikës 16, të vendimit nr. , datë , të Këshillit të Ministrave. - Jap pëlqimin që të mblidhen të dhëna dhe të kryhen procedurat e verifikimit të këtyre të dhënave. - Jam dakord që të dhënat e mia personale të mbledhura në referim të pikës 16, të vendimit nr. , datë , të Këshillit të Ministrave, të trajtohen nga njësitë e vetëqeverisjes vendore për trajtimin e kërkesës sime për të përfituar strehim sipas programeve social të strehimit të parashikuar në ligjin nr. 22/2018, "Për strehimin social.	
	- Nuk jap pëlqimin që të mblidhen të dhënat e nevojshme, sipas parashikimeve tëpikës 16, të vendimit nr. , datë , të Këshillit të Ministrave; - Nuk jap pëlqimin që të mblidhen të dhëna dhe të kryhen procedurat e verifikimit të këtyre të dhënave. - Nuk jam dakord që të dhënat e mia personale të mbledhura, në referim të pikës 16, të vendimit nr. , datë , të Këshillit të Ministrave, të trajtohen nga njësitë e vetëqeverisjes vendore për trajtimin e kërkesës sime për të përfituar strehim sipas programeve sociale të strehimit të parashikuar në ligjin nr. 22/2018, "Për strehimin social".	

Formular 6

KËRKESA PËR TË PËRFITUAR NGA PROGRAMET E STREHIMIT SOCIAL

KËRKESË

PËR T'U TRAJTUAR ME STREHIM, BAZUAR NË LIGJIN NR. 22/2018, "PËR STREHIMIN SOCIAL"

FAZA E PARË E APLIKIMIT

Mbiemri..... emri ..... datëlindja .....

Qyteti.....Njësia administrative .....Rruga.....

Pall .....Shk ....Ap.....(Në rastin e një banese private) Nr ..... Tel .....

I. GJENDJA FAMILJARE

MBIEMRI	EMRI	DATËLINDJA Dita/Muaji/Viti (00/00/0000)	(1) SEKSI	(2) GJENDJA CIVILE	Nr. DOKUMENTI IDENTIFIKIMIT	(3) FAMILJARËT	(4) PUNËSIMI

Në tabelë hidhen kodet, si më poshtë vijon:

1. SEKSI	2. GJENDJA CIVILE	3. FAMILJARËT		4. PUNËSIMI	
Mashkull (M)	Beqar/e	1 Aplikanti	00	Punësuar në shtet	01
Femër (F)	i/e martuar	2 Nëna/Babai	01	Punësuar në privat	02
Nuk	i/e ve	3 Bashkëshorti/ja	02	I/E vetëpunësuar	03
Përgjigjem (N)	i/e divorcuar	4 I biri/E bija	04	Punësim i rastit	04
		Gjysh/e	05	I përfshirë në programin e ndihmës ekonomike	05
		Nip/Mbesë	06	I përfshirë në programin e pagesës së papunësisë	06
		Vjehrri/a	07	Të tjerë	07
		Dhëndri/nusia	08		
		Vëllai/motra	09		
		Kunati/a	10		
		Të tjerë	11		

Shënim: Në kolonat 1, 2, 3 e 4 vendos numrin që i korrespondon gjendjes suaj. Të dhënat e kolonës 3 duhet të korrespondojnë me certifikatën familjare.

II. KUSHTET E STREHIMIT

2.Disponon banesë në pronësi **Po** **Jo**

[1] Në sipërfaqen totale të banimit përfshihen sipërfaqja e dhomave të gjumit plus sipërfaqen e dhomës së ditës, të matura brenda mureve ndarëse.

IV. KUSHTET SOCIALE

Shëno në kutitë që u përshtaten kushteve tuaja sociale

4.1 Ka në përbërje familjare një individ me aftësi të kufizuara ..... □

4.2 Ka statusin e jetimit dhe moshë deri në 30 vjeç ..... □

4.3 Ka mbetur i pastrehë për shkak të lirimit të banesës ish-pronarëve ..... □

4.4 Emigrant i rikthyer / punëtor emigrant □

4.5. Azilkërkues ..... □

4.6 Familje e punonjësit të Policisë së Shtetit të rënë në detyrë ..... □

4.7 Punonjës i Repartit të Ndërhyrjes së Shpejtë (FNSH) ..... □

4.8 Punonjës i RENEA-s ..... a

4.9 Punonjës i Shpëtimit dhe i Mbrojtjes nga Zjarri ..... □

4.10 Viktimë e dhunës në familje ..... □

4.11 Viktimë e trafikimit ..... □

4.12 Anëtar i minoritetit rom ..... □

4.13 Anëtar i minoritetit egjiptian ..... □

4.14 I mitur në konflikt me ligjin ..... □

4.15 Vajza-nëna ..... □

4.16 Komuniteti LGBTI .....

4.17 Anëtar i familjes që trajtohet me ndihmë ekonomike

V. TË ARDHURAT E FAMILJES

1. Ky seksion duhet të plotësohet për çdo person që siguron një të ardhur në familje, në përputhje me kolonat 3 e 4, të tabelës "Gjendja familjare". Në të ardhurat totale të familjes përfshihen të ardhurat neto nga punësimi, dypunësimi, pagesa e papunësisë, pagesa e ndihmës ekonomike, pensioni, dërgesa nga emigracioni, qira nga prona, transferta të tjera nga të afërm, si dhe çdo

Në mungesë të banesave sociale me qira dhe në mungesë të banesave me kosto të ulët, njësia e vetëqeverisjes vendore ofron një nga instrumentet e mëposhtme financiare. Nëse ju pranoni, duhet të shënoni:

Pranoj Nuk/pranoj

Në mungesë të banesave sociale, ofrohet subvencionimi qirase në vlerën e lirë .....

Në mungesë të banesave me kosto të ulët, ofrohet, sipas mundësive buxhetore, subvencionimi i interesave të kredive....